Nga:Drejtoria për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi

Përshkrim i shkurtër rreth Planit Rregullues Urban

Plani Rregullues Urban (PRRU) në Shtime me nr.01/78 është aprovuar me 31.03.2011 nga Kuvendi Komunal i Shtimes.

Plani Rregullues Urban i Shtimes përfshinë tërë zonën Kadastrale të Shtimes si dhe një pjesë të zonës Kadastrale të Lagjës.

Me këtë planë janë caktuar kushtet për rregullimin e hapësirës, rregullat e lokacionit të objekteve dhe ngastrave tokësore urbane. Plani Rregullues Urban ka definuar zonat e ndërtimit ku janë përfshire linjat e rregullimit të ndërtimit, normat teknike urbanistike dhe kushtet tjera lidhur me lokacionin e ndërtesave dhe ngastrave tokësore urbane të ndërtesave tjera.

Me Planin Rregullues synohet të arrihet:

I. Sigurimi dhe destinimi i sipërfaqeve për përmbushjen e nevojave të banorëve të kësaj zone hapësinore
II. Mundësia e ndërtimit me koncesion – banim kolektiv dhe afarizëm me interes të pronarëve dhe investitorëve në funksion të zonës urbane
III. Sigurimi i infrastrukturës së re teknike komunale: ujësjellësi, kanalizimi, instalimet elektrike, ngrohja qendrore, gazifikimi, rrjeti i internetit, sistemi i rrjetit kabllovik, telefonia, etj.
IV. Integrimi i objekteve të reja të banimit atyre publike, sociale etj. në kuadër të hapësirës urbane
V. Ngritja e nivelit të kushteve dhe mundësive për banim, punë, argëtim, rekreacion, gjelbërim etj.
VI. Eliminimi i pikave ndotëse dhe krijimi i mundësive për jetë të shëndoshë në ambiente të pastërta dhe të shëndosha
VII. Mbrojtja e gjelbërimit ekzistues dhe shfrytëzimi i hapësirave gjelbëruese për rekreacion, argëtim dhe pushim.
VIII. Mundësia e shkarkimit të komunikacionit në hapësirën urbane ngritjen e shkallës së sigurisë.
IX. Për persona me aftësi të kufizuara,pleq,fëmijë
X. Qasje e lehtë në infrastrukturë komunale